

*Model 1***Format kërkesë**

Ligji për të Drejtën e Informimit

Ky shërbim është i tarifuar. Lutemi kryeni pagesën për shërbimin e kërkuar.

Kërkesë për: ☐ Informacion të përgjithshëm ☐ Informacion personal ☐ Informacion për të tjerë	Drejtuar:
---	-----------

Kërkesë për akses në _____			
Kërkesë për të dhëna personale si _____			
Emër Mbiemër :	Shtetësia:	Adresa:	Data: dd/mm/vvv
Z./Znj. _____		Nr. Tel. :	Firma:

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Kërkohet kopje ☐		Data
Kërkohet origjinali ☐		Firma

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes:	Numri i kërkesës:	Komente

Informacioni në këtë format është marrë në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky informacion ka përmbajtje konfidenciale dhe përmban gjithashtu të dhëna personale . Është i ndaluar printimi apo shpërndarja nga persona dhe subjekte të ndryshëm prej marrësit të destinuar të këtij formati. Për sqarime më të detajuara kontaktoni KDIMDP ose kordinatorin e institucionit të cilit i drejtoheni.

SHËNIME SHPJEGUESE

Hapi 1

Përcaktoni cili institucion ka më tepër gjasa që të ketë informacionin që ju jeni duke kërkuar. Vendosni nëse ju dëshironi që të dorëzoni një kërkesë joformale për informacion ose një kërkesë formale për Aksesin e Informacionit në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Nëse ju dëshironi të bëni një kërkesë informale, sigurohuni të kontaktoni institucionin e duhur. Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Hapi 2

Për të aplikuar për informacion sipas Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, plotësoni këtë formular, përshkruani informacionin duke dhënë detaje të rëndësishme të nevojshme për të ndihmuar institucionin për të identifikuar informacionin e kërkuar. Nëse keni nevojë për ndihmë, referojuni faqes zyrtare ***www.idp.al***

Hapi 3

Drejtoni kërkesën tuaj Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Mbani parasysh faktin se informacioni i kërkuar ofrohet kundrejt një pagese, e cila përcaktohet në varësi të llojit ose sasisë së informacionit që kërkohet.

Ju mund t’ju kërkohen autorizime të mëtejshme, për këtë do të njoftoheni sipas rastit.

Lutemi sigurohuni që kontaktet tuaja janë të sakta.

Hapi 4

Kur ju të merrni një përgjigje për kërkesën tuaj për informacion, të shqyrtuar nga institucioni për të cilën ju dëshironi të bëni një kërkesë të përsëritur apo ankesë sipas ligjit, kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, ju gjithashtu keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.